

Lirika

BIBLIOTEKA
SHTETIT

844
RPL

Germa dashurie

Llambro
G. Ruci





Llabro Ruci, ka lindur më 1946 në Dhërmi të Vlorës. Ka përfunduar Politeknikumin «7 Nëntori» në Tiranë dhe deri në vitin 1971 ka punuar në Hidrocentralin «J. V. Stalin» të Bistricës. Tani është student në degën e gazetarisë të USHT.

Ka botuar vëllimet poetike «Jam elektrikist» (1967) dhe «Vij nga bregdeti» (1970). Shkruan shkrime të ndryshme publicistikë dhe një sërë tregimesh fantastiko-shkencorë për fëmijë, etj.

Ky është libri i tij i tretë.

844-1
RP1

LLAMBRO G. RUCI

Germa Dashurie

Lirika



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor: RAMAZAN VOZGA

Piiktor: SAFO MARKO

Tirazhi 2000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1973

GERMA DASHURIE

Ylberet pas shiut i kam dashuruar, por s'i kam
prekur dot;
detin e kaltër e kam çarë me pash, nuk arrita t'i gjej
fundin;
diellin e kam ndjekur me sy qëkur lind gjer perëndon,
s'munda asnjëherë ta mbaj mbi supe;

erën e kam ndjerë veshur e zhveshur në gryka e
hapësira,
si mund ta mbash erën në pëllëmbë?
Frutave të tokës ua njoh shijen, jam i ngopur me to;

të gjitha m'i solle Ti,
5 gërma dashurie:

P a r t i !

I pëshpërisin fëmijët e doçkat mbi globin e ëndrrave
ulin,
e timpanin e zemrës vënë në hapat e diellit;
njerzit me sy i përkëdhelin dhe pemët e gëzimeve
zgjaten, zgjaten
dhe ditët ikin më shpejt,
e stinët piqen më shpejt!

Të kam parë dhe të kam takuar gjithë jetën midis
njerëzve.

1971

B U T R I N T

ty Lavda

Midis kolonave të amfiteatrit u ndalëm: të ngrëna
nga era e uji,

si drurë të djegur nga rrufetë.

Mure gjysëm të rrëzuar nga pesha e kohës. Mbësh-
tesim sytë tanë

dhe ato dridhën...

Mbase kujtojnë rininë e tyre,

ndofta mjekrën e Ali Pashait nën harkun e breshë-
rive të topave.

si një cfurk i zjarrtë ngulur në ijet e perandorisë.

Pusi i virgjërshave me buzë të brejtura nga litarët
e shtëmbave.

Hapat e kumbimit, majë gishtrinjve, vinë rrotull
nesh

me meloditë mjergullore të fyejve, që tundin degët
e dafinave

(të gjelbra, të gjelbra ato rriten brënda nesh!)

e përmes tyre një heshtë e mprehtë si gishti tregues
midis buzëve,
si përcjellja e nuseve, larg qëmoti nga nënat në Jug.
Ku veni moj korba?
si rruga për në dhe të huaj përmes një rrebeshi të zi.

Është e largët historia
po ne e ndiejmë rritjen, transformimin brënda vetes...

Prekim gurët.

Nën to filli i legjendave, si peri i ballonave të fëmi-
jëve,

na shpie tek Dea.

«Zonjë shtëpie dil në prag
të presish të porsaardhurit.

Urdhëro të ndezin zjarr, të bien trompetat e gëzimeve
dhe vajzat të sjellin lule!»

Ky është Butrinti. I rëndë si gurët e kalasë,
që kanë zënë vend pranë portës së luanit,
si një pjesë e përfytyrimit për këtë kafshë-simbol
të trimërisë,
i lehtë si ky mozaik, ku pasqyrohen dantellat e
pemëve,
qetësia e barit dhe velat e briri i artë i alarmit,
mbështetur në ballin e agimit.

Flasim dhe jehona e zërave kthehet prapsht. Mos
vallë

nuk dimë të shqiptojmë qartë gjuhën tonë?
Jo mos u tremb, këtu akustika e kohës është e qartë.

Dëgjon e dashur, sa herë të flasësh, ndalu të dëgjosh
jehonën!

1972

STUDENTËT KËPUTËN TËRË DEGËT E VJESHTËS

Këputëm tërë degët e vjeshtës
në mëngjezet e lagur të stërvitjes.

S'jemi indianë lëkurëkuq,
që kërkojmë skalpet e fitores a gjahun e madh,
po ushtarë si gjithë ushtarët
që nxjerrin bajonetat përpara në mjegull e baltë.

Qerpikët e vajzave u lagën nga vesa e dëllinjave,
vajzat në pushim kërkojnë lule vjollce.

Në ndodhtë që këto kodra rreptë të gjëmojnë
nën kosat e harbuara të krismave,
edhe atëhere s'do harrojmë
lulet që na mblodhën shoqet.

1972